

Ndikimi i subvencioneve

në prodhimin bujqësor



Ndikimi i **subvencioneve** në prodhimin bujqësor

Korrik 2021

— Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	3
2.	Hyrje	4
3.	Subvencionet në drithëra dhe vreshta	5
	3.1 Gruri	5
	3.2 Misri	7
	3.3 Elbi	9
	3.4 Farë gruri	10
	3.5 Thekra	12
	3.6 Vreshta ekzistuese	13
4.	Subvencionet në blegtori dhe shpeztari	15
	4.1 Lopë qumështore	15
	4.2 Pula vojse	17
	4.3 Koshere bletë	18
	4.4 Dele dhe dhi	19
5.	Përfundimi	21

1. Përmbledhje ekzekutive

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e bilancit tregtar, rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Plani për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 2007-2013 është ndër dokumentet më të hershme ku u hartuan politikat e para mbështetëse të zhvillimit të bujqësisë. Ky dokument vlerëson se një ndër shkaqet kryesore që vështirësojnë prodhimtarinë bujqësore janë struktura e vogël e fermave dhe niveli i lartë i fragmentimit të tokave. Si rrjedhojë, politikat mbështetëse u hartuan pikërisht për përmirësimin e këtyre problemeve. Por, cili ka qenë ndikimi i këtij programi mbështetës në përmirësimin e strukturës dhe rritjes së prodhimtarisë bujqësore?

Në dy raporte të ndara, Instituti GAP ka analizuar se si kanë ndikuar grantet¹ dhe subvencionet në prodhimin bujqësor. Nga viti 2015 deri më 2019 janë shpërndarë rreth 134.7 milionë euro në pagesa direkte (subvencione) nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në drithëra, vreshta, blegtori dhe shpeztari. Në shumicën e kulturave bujqësore, prodhimi, sipërfaqja e mbjellur dhe rendimenti në vitin 2019 nuk duket të ketë ndryshuar shumë krahasuar me periudhën para fillimit të politikave mbështetëse. Në raste ku ka rritje të prodhimit ose të rendimentit, kjo rritje është shumë më e ulët se rritja e pagesave direkte ndër vite.

Ky hulumtim nxjerr në pah se rendimenti i grurit në vitin 2019 ishte më i ulët për 4.3 përqind krahasuar me vitin 2010. Sipërfaqja e mbjellur me grurë është rritur për 2.4 përqind mirëpo shuma e pagesave direkte është rritur për 150 përqind. Elbi ka rritje të sipërfaqes së mbjellur për 63 përqind nga viti i shpërndarjes së pagesave direkte deri në 2019, mirëpo trefishim të subvencioneve. Në anën tjetër, nuk vërehet ndonjë përmirësimi i strukturës së tokës së mbjellur. Në industrinë e prodhimit të qumështit, përkundër trefishimit të pagesave direkte ndër vite dhe rritjes së pagesave për krerë, numri i lopëve qumështore dhe prodhimi i qumështit është zvogëluar për rreth 30%. Gjatë viteve 2008-2009, numri i lopëve qumështore ishte rreth 60 mijë më i lartë se në vitet 2018-2019, ndërsa prodhimi i qumështit mbi 100 mijë ton.

Mungesa e arritjes së rezultateve të pritura përkundër përkrahjes së lartë financiare vë në pikëpyetje efektshmërinë e politikave bujqësore apo mënyrën e shpërndarjes së tyre. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, menaxhimi i sektorit të bujqësisë ka mangësi të mëdha. Instituti GAP rekomandon të bëhet një vlerësim i detajuar nëse mungesa e rezultateve të pritshme është si pasojë e politikave bujqësore joadekuate apo nga menaxhimi jo i duhur i fondeve.

¹ Instituti GAP, 2021, "Ndikimi i granteve në prodhimin bujqësor".

2. Hyrje

Zhvillimi i bujqësisë mbetet një ndër prioritetet ekonomike të vendit i përfshirë në secilin program qeverisës.² Potenciali i saj qëndron kryesisht në zëvendësimin e importit i cili vazhdon të jetë tejet i lartë, posaçërisht në produkte ushqimore. Nga viti 2014 deri në vitin 2019, deficitit tregtar në produkte bujqësore është rritur për 20.3%.³ Ky trend pasqyron rritjen e kërkesës së brendshme dhe pamundësinë e plotësimit të saj nga prodhimi vendor. Zhvillimi i bujqësisë përveç zëvendësimit të importit, paraqet mundësi të mirë edhe në rritjen e eksportit i cili mund të kontribuojë në rritjen e punësimit në zona rurale ku papunësia vazhdon të jetë e lartë.

Një ndër dokumentet më të hershme që identifikon mangësitë e zhvillimit të bujqësisë në Kosovë është “Plani për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 2007-2013”, i cili më pas u zëvendësua me një version të rishikuar 2010-2013. Ky dokument vlerëson se një ndër shkaqet kryesore të performancës së dobët të prodhimtarisë bujqësore është struktura e vogël e fermave dhe niveli i lartë i fragmentimit të tokave.⁴ Kjo strukturë e pafavorshme e fermave dhe tokave të punueshme ka ndikuar që prodhimi bujqësor të mbetet kryesisht ekzistencial i cili në masë të madhe përdoret për konsum vetanak dhe jo për prodhim komercial. Probleme të tjera të indentifikuara në këtë dokument janë qasja e ulët e fermerëve në financa, mungesa e edukimit adekuat në rritjen e rendimentit, cilësia e dobët e prodhimit, e të tjera.⁵

Në të njëjtin dokument, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar një sërë politikash bujqësore të cilat kishin për synim rritjen e prodhimit komercial përmes ofrimit të stimuljeve financiar si pagesat direkte. Pagesat direkte apo subvencionet janë të holla të garantuara që jepen për hektar tokë të mbjellur për kultura të ndryshme bujqësore ose pagesa për krerë bagëti.

Në vitin 2013 u hartua Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, duke përfshirë edhe kultura të tjera të drithërave dhe bagëtive. Përveç zgjerimit të mbështetjes, u rrit edhe shuma e shpërndarjes së financimit publik nga viti në vit. Këto politika bujqësore u dizajnuan në mënyrë që të përmirësonin problemet e lartëpërmendura.⁶ Për shembull, shpërndarja e pagesave direkte për hektar tokë të mbjellur dhe vendosja e numrit minimal të tokës së punuar synonte shtimin e madhësisë së fermës, dhe parandalimin e copëzimit të mëtutjeshëm të tokës. Kjo masë synonte rritjen e prodhimit komercial dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimit. Ndërsa, pagesat për krerë bagëti u vendosën si stimuj për fermerë që të rrisnin numrin e bagëtisë përmes së cilës synohej rritja e prodhimit bujqësor.

Nga viti 2015 deri më 2019 janë shpërndarë rreth 134.7 milionë euro në subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.⁷ Edhe pse në mënyrë të vazhdueshme është investuar për zhvillim dhe rritje të prodhimit bujqësor, ende nuk është publikuar një raport gjithëpërfshirës nga kjo ministri i cili do bënte të ditur efektin e këtyre investimeve në kapacitetet prodhuese.

Në këtë raport, Instituti GAP synon të paraqes ndikimin e subvencioneve në prodhimin dhe ristrukturimin e bujqësisë. Vlerësimi është bërë duke përzgjedhur kulturat bujqësore më të përkrahura nga fillimi i hartimit të politikave bujqësore. Fillimisht është paraqitur ndikimi i pagesave direkte në drithëra dhe vreshta, dhe pastaj në blegtori dhe shpeztari.

2 Programi Qeverisës 2020-2023. Publikuar në maj 2020. Burimi: <https://bit.ly/2QoLxrE>

Programi Qeverisës 2020-2023. Publikuar në maj 2021. Burimi: <https://bit.ly/3xXt949>

3 Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Raporti i Gjellbër 2020. Burimi: <https://bit.ly/3vORXKy>

4 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-13. Burimi: <https://bit.ly/3s6x5cr>

5 Ibid.

6 Ibid.

7 MBPZHR, Bujqësia e Kosovës në numra 2020. Burimi: <https://bit.ly/33xwLfb>

3. Subvencionet në drithëra dhe vreshta

3.1 Gruri

Mbjellja e grurit në prodhimtarinë bujqësore ka rëndësi të veçantë strategjike dhe ekonomike. Gruri është pjesë përbërëse e shumë produkteve ushqimore, i cili përdoret për prodhimin e bukës, si ushqim për kafshë dhe në disa raste si ushqim për shpendë. Gruri është kultura bujqësore më e kultivuar në kategorinë e drithërave ku rreth 66 përqind e tokës së punueshme është e mbjellur me grurë.⁸

Mirëpo përkundër këtij prodhimi, Kosova asnjë vit nuk arrin t'i përmbush nevojat e saj për grurë. Problemet kryesore në kultivimin e grurit janë rendimenti i ulët dhe tokat e ndara në parcela të vogla që vështirësojnë prodhimin në masë.

Për të ndihmuar rritjen e prodhimit, në vitin 2010 MBPZhR për herë të parë realizoi pagesat direkte apo subvencionet për fermerët që kultivojnë grurë. Nga viti 2010 deri në vitin 2019 janë shpenzuar mbi 52 milionë euro në pagesa direkte për mbjellje të grurit. Qëllimi i këtij programi ishte dhe vazhdon të jetë rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore. Andaj kriteret e vendosura për të përfituar pagesa direkte për mbjellje të grurit kanë për qëllim arritjen e këtyre synimeve.

Për të ofruar stimuj në rritjen e tokës së mbjellur me grurë, përfituesve u kërkohej që: a) të kenë të mbjellur së paku dy hektarë me grurë në pronësi, b) parcela e mbjellur me grurë duhet të jetë së paku 0.20 hektarë e pandarë, c) sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit, dhe e) sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.50 hektar e pandarë.⁹ Rritja e tokës së mbjellur për fermerë mundëson prodhimin në masë, rritjen e rendimentit dhe arritjen e ekonomisë së shkallës që do të thotë zvogëlimin e kostonë së prodhimit si pasojë e prodhimit në masë.

Megjithatë, krahasuar me vitin 2010, rendimenti i grurit në vitin 2019 është reduktuar për 4.3 përqind duke ndikuar që edhe prodhimi të zvogëlohet për 3.2 përqind. Sipërfaqja e mbjellur me grurë është rritur për 2.4 përqind ndërsa shuma e pagesave direkte për 150 përqind. Sa i përket ekonomizimit të prodhimit, nga viti 2010, sipërfaqja mesatare e subvencionuar me grurë për fermer ka vazhduar të bie nga 4.6 hektarë në vitin 2010 në 4.1 hektarë në vitin 2019. Kjo është një rënie prej 11.4 përqind e cila vështirëson prodhimin në masë dhe realizimin e ekonomisë së shkallës.

⁸ Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Raporti i Gjellbër 2020. Burimi: <https://bit.ly/3vORXKy>

⁹ MPZhR, Programi për pagesa direkte për vitin 2019. Burimi: <https://bit.ly/2QB3OMI>


Tabela 1. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në prodhimin e grurit për vitet 2010-2019

Ndryshimi
2019/2010

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	
Sipërfaqja (ha)	78,420	79,928	102,918	101,846	90,728	89,942	89,122	80,519	81,123	80,273	2%
Prodhimi (ton)	294,540	300,203	345,027	391,727	331,296	304,443	365,651	320,136	280,616	284,999	-3%
Rendimenti (t/ha)	3.76	3.76	3.35	3.85	3.65	3.40	4.10	4.00	3.50	3.60	-4%
Pagesat direkte	2,121,010	3,206,956	3,795,094	5,824,268	5,555,218	6,417,047	7,526,999	5,781,300	6,550,929	5,292,996	150%
Njësi të subvencionuara (ha)	23,566	32,070	37,951	46,594	44,442	42,780	50,180	38,542	43,673	35,287	50%
Pagesa për ha	90	100	100	125	125	150	150	150	150	150	67%
Nr. përfituesve	5,145	8,364	8,841	10,686	10,579	10,298	11,602	9,216	10,311	8,699	69%
Sipërfaqja (ha) mesatare për fermer	15.24	9.56	11.64	9.53	8.58	8.73	7.68	8.74	7.87	9.23	-39%

Raporti i Gjelbër 2014-2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 1. Sipërfaqja dhe pagesat direkte për grurë gjatë viteve 2010-2019



Burimi: Raporti i Gjelbër 2014-2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Rritja e pagesave nga viti në vit për këtë kulturë bujqësore nuk duket të ketë pasur ndikim në rritjen e sipërfaqes së mbjellur. Madje pagesat direkte nuk kanë arritur as të ndyshojnë strukturën e parcelave të mbjellura. Prodhimi i grurit vazhdon të realizohet nga fermerët me kapacitete të ulëta të prodhimit. Si rrjedhojë, prodhimi i pamjaftueshëm ka shkaktuar varësi në import, ku krahasuar me vitin 2012, importi i grurit si sasi (ton) është rritur për 24 përqind.

Tabela 2. Importi i grurit në vlera dhe sasi gjatë viteve 2012-2019


	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2012
Vlera (në 1,000 €)	21,786	15,870	16,617	18,068	19,501	16,447	20,404	24,125	11%
Sasia (ton)	96,994	78,168	89,151	98,063	127,123	97,208	114,054	120,489	24%

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), përpunuar nga DAESB¹⁰

¹⁰ Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore (DAESB). Burimi: <https://bit.ly/39YCizm>

Varësia në import shoqërohet me pasiguri në furnizim dhe çmim. Në nëntor të vitit 2018, kur Qeveria e Kosovës vendosi tarifën 100 përqind ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina (BiH), çmimet e grurit pësuan ndryshime të mëdha. Figura 2 paraqet rritjen e çmimit të bukës dhe drithërave pas nëntorit të vitit 2018 e më pas stabilizimin e tyre pas gjetjes së furintorëve të tjerë në rajon.

Figura 2. Ndryshimet mujore të çmimi të bukës dhe drithërave gjatë viteve 2017-2020



Burimi: ASK¹¹

3.2 Misri

Misri është bimë me potencial të lartë prodhues. Mbjellja e misrit ka rëndësi të veçantë në prodhimtarinë bujqësore sepse është pjesë përbërëse e shumë produkteve ushqimore si mielli, buka, supa, sallata, vaji, pasta dhe të tjera. Misri gjithashtu përdoret edhe si ushqim për kafshë.

Në vitin 2012 filloi subvencionimi me pagesa direkte për fermerët që kultivonin misër. Deri në vitin 2019 janë shpenzuar mbi 19 milionë euro në pagesa direkte për mbjellje të misrit. Qëllimi i programit është i njëjtë me atë të sektorit të grurit ku synohet rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore. Për subvencionimin e fermerëve u kërkohet që në pronësi të kenë së paku dy hektarë të mbjellur me misër për së paku 0.20 hektarë parcelë të pandarë. Ndërsa, fermerët qiramarrës është e nevojshme për të paktën një vit të posedojnë sipërfaqe të kontraktuar me së paku 0.50 hektar sipërfaqe të pandarë.¹²

Për dallim nga gruri, misri nga viti 2012 ka një rritje të lehtë të rendimentit, prodhimit dhe të sipërfaqës së mbjellur. Mirëpo, rritja e pagesave direkte është shumë më e lartë se rritja e sipërfaqës së mbjellur. Nga viti 2012 deri në vitin 2019, toka e mbjellur me misër është rritur për 26 përqind ndërsa pagesat direkte janë shtatëfishuar (Figura 4).

¹¹ Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3cXz7tw>

¹² Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Burimi: <https://bit.ly/3aNzleG>


Tabela 3. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në prodhimin e misrit për vitet 2012-2019

Ndryshimi
2019/2012

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	
Sipërfaqja (ha)	31,181	36,122	35,038	41,492	41,524	35,951	38,453	39,441	26%
Prodhimi (ton)	86,304	136,633	116,209	131,486	186,592	147,200	151,921	163,930	90%
Rendimenti (t/ha)	2.8	3.8	3.3	3.2	4.5	4.1	4.0	4.2	50%
Pagesat direkte	575,459	943,028	1,268,719	2,735,462	2,870,969	3,311,579	3,227,784	4,122,464	616%
Njësi të subvencionuara (ha)	5,755	9,430	12,687	18,236	19,140	22,077	21,519	27,483	378%
Pagesa për ha	100	100	100	150	150	150	150	150	50%
Nr. përfituesve	2,209	3,626	5,413	7,574	7,763	8,231	8,165	9,370	324%
Sipërfaqja (ha) mesatare për fermer	14.12	9.96	6.47	5.48	5.35	4.37	4.71	4.21	-70.18%

Burimi: Raporti i Gjelbër 2014-2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 3. Sipërfaqja dhe pagesat direkte për misër gjatë viteve 2012-2019



Burimi: Raporti i Gjelbër 2014-2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Sipërfaqja mesatare e subvencionuar me misër për fermer ka shënuar një ngritje të lehtë nga 2.6 hektarë për përfitues në vitin 2012, në 2.9 hektarë në vitin 2019. Kjo rritje e njësisë së subvencionuar për fermer është hap i mirë drejt prodhimit në masë dhe realizimit të ekonomisë së shkallës. Megjithatë, kjo rritje është e pamjaftueshme ngase deri më tani prodhimi i misrit është më i vogël se kërkesa e tregut të Kosovës. Nga fillimi i subvencionimit të kësaj kulture bujqësore, importi në ton është rritur për 96%. Prandaj, përkundër rritjes së lehtë të prodhimit, pagesat direkte nga viti 2012 janë shumëfishuar ndërsa nevojat e tregut edhe më tutje plotësohen nga importi i cili nga viti 2012 pothuajse është dyfishuar.

Tabela 4. Importi i misrit në vlera dhe sasi gjatë viteve 2012-2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2012
Vlera (në 1,000 €)	4,829	5,234	5,602	6,911	8,102	7,698	8,051	7,901	64%
Sasia (ton)	24,425	29,425	34,956	42,944	52,439	48,318	50,684	47,754	96%


Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), përpunuar nga DAESB¹³

3.3 Elbi

Elbi është kulturë bujqësore tradicionale e cila mbillet në të gjithë territorin e Kosovës dhe përfshin mesatarisht rreth 1,500 hektarë tokë apo 1.6% e sipërfaqës së mbjellur me drithëra.¹⁴ Zhvillimi i këtij sektori është i rëndësishëm për prodhimin e birrës dhe ushqimit të kafshëve, poashtu për rritjen e të ardhurave të fermerëve në këtë sektor.

Në vitin 2016, programi i pagesave direkte i MBPZHR-së filloi subvencionimin për fermerët që kultivojnë elbin. Qëllimi i subvencionimit edhe këtu mbetet i njëjtë me kulturat e lartëcekura si rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.¹⁵ Gjatë viteve 2016-2019, janë shpërndarë mbi 240 mijë euro për rritjen e kapacitetit prodhues të elbit. Programi për pagesa direkte, si kriteret që duhet arritur aplikuesit paraqet kërkesën për pronësinë e së paku një hektari tokë të mbjellur me elb me së paku 0.20 hektar të pandarë. Ndërsa, fermerët qiramarrës kërkohet të paktën një vit të kenë paguar qiranë për së paku 0.50 ha parcelë të pandarë.¹⁶

Ngjashëm si me prodhimtarinë e misrit, elbi ka rritje të sipërfaqes së mbjellë për 63 përqind nga viti i shpërndarjes së pagesave direkte deri në 2019 dhe trefishim të subvencioneve. Në anën tjetër, nuk vërehet ndonjë rritje e njësive të subvencionuara për fermerë të cilat do të mundësonin përmirësimin e strukturës së tokës së mbjellur dhe prodhimit në masë.

Figura 4. Sipërfaqja dhe pagesat direkte për elb gjatë viteve 2016-2019

Burimi: Raporti i Gjelbër 2014-2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

¹³ Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore (DAESB). Burimi: <https://bit.ly/39YCizm>

¹⁴ Katalogu ekonomik për prodhime bujqësore 2020. Burimi: <https://bit.ly/2RKqiux>

¹⁵ Programi për pagesa direkte. MPZHR. Burimi: <https://bit.ly/2QB3OMl>

¹⁶ Ibid.

Nga viti 2008 deri në vitin 2019, rendimenti i elbit ka vlerën mesatare rreth 3 t/ha ndërsa vlera më e lartë e realizuar gjatë kësaj periudhe është 3.2 t/ha në vitet 2012, 2013 dhe 2014. Përkundër zbatimit të programit për pagesa direkte nga viti 2016 deri më 2019 është vërejtur rënie e ulët e rendimentit.

Tabela 5. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në prodhimin e elbit për vitet 2016-2019

	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2016
Sipërfaqja (ha)	1,196	1,605	1,948	1,954	63%
Prodhimi (ton)	3,669	4,687	5,124	5,159	41%
Rendimenti (t/ha)	3.07	2.92	2.63	2.64	-14%
Pagesat direkte	25,118	38,662	77,688	73,194	191%
Njësi të subvencionuara	251	387	518	488	94%
Nr. Përfutuesve	133	208	306	267	101%
Sipërfaqja (ha) mesatare për fermer	8.99	7.72	6.37	7.32	-18.62%

Burimi: Raporti i Gjellbër 2020 dhe Katalogu Ekonomik për Prodhime Bujqësore 2020

Rritja e prodhimit të elbit është shoqëruar me rënie të importit për këtë kategori. Megjithatë nevojat e tregut të Kosovës për këtë kulturë bujqësore janë relativisht të ulëta, rritja e mëtutjeshme e prodhimit mund t'i plotësojë nevojat vendore plotësisht dhe të mundësojë rritjen e eksportit.

Tabela 6. Deficiti tregtar i elbit në vlera gjatë viteve 2016-2019

	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2016
Deficiti tregtar (€)	-28,300	-11,826	-21,201	-13,510	-52%

Burimi: Dogana e Kosovës

3.4 Farë gruri

Procesi i prodhimit të farës së grurit kalon në disa faza dhe si i tillë është një veprimtari ekonomike e kushtueshme. Sigurimi i farës cilësore, shumëzimi, parakultura, inspektimet fushore, përpunimi, etiketimi, mostrimi i farës si dhe masat shtesë të mbrojtjes rrisin dhe më shumë nevojën për mbështetje financiare.¹⁷

Në vitin 2012 filloi subvencionimi me pagesa direkte për fermerët që kultivojnë farë gruri. Deri në vitin 2019 janë shpërndarë mbi 855 mijë euro. Qëllimi fillestar i këtij programi është rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit të farës së grurit dhe grurit merkantil, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit, rritja e kapaciteteve përpunuese dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore. Përmes kësaj mbështetjeje synohet të arrihet sigurimi i farës së grurit brenda vendit.¹⁸

Programi për pagesa direkte, ofron pjesëmarrje më të madhe të pagesave për kultivuesit e farës së grurit, ndërsa paraqet këto kriterë të subvencionimit për aplikuesit: a) të kenë të mbjellur së paku pesë hektarë për prodhimin e farës, b)

¹⁷ MBPZHR. Programi për pagesat direkte për vitin 2015. Burimi: <https://bit.ly/3wdD5Wq>

¹⁸ MBPZHR. Programi për pagesat direkte për vitin 2019. Burimi: <https://bit.ly/31mTtWf>

të posedojnë kontratën me kompaninë prodhuese të farës, c) parcela e mbjellë me grurë për farë ose e marrë me qira për mbjelljen e grurit për farë, duhet të jetë së paku një hektarë e pandarë; d) sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit; e) fara e varietetit të grurit të mbjellur duhet të jetë në listën e farërave të lejuara.¹⁹

Pas fillimit të mbështetjes së prodhimit të farës së grurit deri më 2019, shuma e pagesave direkte është rritur për 461%, nga 25 mijë në mbi 140 mijë në vit, ndërsa sipërfaqja e mbjellur me këtë kulturë bujqësore ka shënuar rënie prej 4%. Në mungesë të të dhënave të prodhimit dhe rendimentit, shohim se mbështetja e këtij sektori nuk duket të ketë luajtur ndonjë rol në rritjen e sipërfaqës së mbjellur me farë gruri. Sipërfaqja e mbjellur ka lëvizur shumë ndër vite duke bërë trendin e prodhimit ende të paqartë.


Një tjetër fakt që vërehet është se nga viti 2012 deri në 2019 vazhdimisht ka pasur rritje të njësive të subvencionuara për fermer. Kjo mund të jetë një indikacion se ka rritje të tokës së mbjellur për fermer gjë që mundëson në afat të gjatë përmirësimin e ekonomisë së shkallës. Megjithatë, deri më tani ky faktor nuk ka ndikuar në rritje të tokës së mbjellur me farë gruri.

Tabela 7. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në prodhimin e farës së grurit për vitet 2012-2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2012
Sipërfaqja (ha)	601	850	610	390	795	470	460	575	-4%
Pagesat direkte	25,020	63,720	107,391	86,063	196,678	122,003	114,204	140,395	461%
Njësi të subvencionuara (ha)	250	850	511	344	803	508	458	562	125%
Pagesa për ha	100	75	210	250	250	250	250	250	150%
Nr. përfituesve	10	27	16	11	25	11	11	15	50%
Sipërfaqja (ha) mesatare për fermer	60.10	31.48	38.13	35.45	31.80	42.73	41.82	38.33	-36.22%

Burimi: Raporti i Gjelbër 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Katalogu Ekonomik për Prodhime Bujqësore 2020

Figura 5. Sipërfaqja e mbjellur dhe pagesat direkte për farë gruri gjatë viteve 2012-2019



Importi i farës së grurit si vlerë dhe sasi ka vazhduar të bie gradualisht nga viti 2012. Kosova vazhdon të importojë farë guri, mirëpo me një varësi më të lehtë në import. Marrë parasysh rënien e sipërfaqës së tokës së mbjellur me farë gruri, rënia e importit mund të jetë edhe si rezultat i zvogëlimit të kërkesës të brendshme.

Tabela 8. Importi i farës së grurit në vlera dhe sasi gjatë viteve 2012-2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2012
Vlera (në 1,000 €)	7,503	4,307	3,369	3,515	2,526	2,531	2,196	1,865	-75%
Sasia (ton)	25,728	14,920	10,954	10,845	8,160	7,848	6,639	5,288	-79%

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), përpunuar nga DAESB²⁰

3.5 Thekra

Thekra paraqet rëndësi të lartë në prodhimin bujqësor pasi përbën veti të larta ushqyese (fibra, proteina, kalium, kalcium, hekur, fosfor, magnez e të tjera) dhe gjithashtu përdoret si pjesë përbërëse e shumë produkteve ushqimore. Në vitin 2016 filloi subvencionimi me pagesa direkte për fermerët që kultivojnë thekër. Qëllimi i programit për këtë sektor është rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.²¹

Nga viti 2016, përmes programit për pagesa direkte, ofrohet mbështetje financiare për kultivuesit e thekrës të cilët kanë shpreh interes dhe dëshmojnë se kanë të mbjella të paktën një hektar me thekër me së paku 0.20 hektar parcelë të pandarë. Ndërsa, nga fermerët qiramarrës kërkohet që sipërfaqen e tokës të marrë me qira ta kenë kontraktuar së paku për një vit për jo më pak se 0.50 hektar parcelë të pandarë.²²

Rendimenti i thekrës nga viti 2008 deri në vitin 2019 ka vlerë mesatare 2.4 t/h ndërsa rendimenti më i lartë i realizuar gjatë kësaj periudhe është 2.9 t/h në vitin 2005. Me qëllim që rendimenti për thekër të jetë dhe më i lartë, në vitin 2016, për fermerët të cilët kultivojnë thekër dhe përmbushin kriteret për subvencionim u ndanë pagesa direkte. Pas zbatimit të programit për pagesave direkte, nga viti 2016 deri në vitin 2019, rritja më e lartë e realizuar për rendimentin e thekrës është 0.3 t/ha në vitin 2017, ndërsa në vitin 2016, 2017 dhe 2019 rendimenti i thekrës kishte vlerën 2.4 t/ha.

Me shpërndarjen e pagesave direkte për kultivimin e thekrës nuk vërehet as rritje substanciale e sipërfaqes së mbjellur dhe as prodhimit. Gjatë viteve 2016-2019, janë mbjellur vetëm një përqind hektarë më shumë thekër me ç'rast prodhimi është rritur për 2 përqind, në anën tjetër pagesat direkte janë rritur për 47 përqind.

²⁰ Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore (DAESB). Burimi: <https://bit.ly/39YCizm>

²¹ Programi për pagesa direkte. MPZHR. Burimi: <https://bit.ly/3f7vXD1>

²² Ibid.

Tabela 9. Indikatorët e performancës së pagesave direkte për kulturën e thekrës gjatë viteve 2016-2019

	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2016
Sipërfaqja (ha)	414.89	318.17	434.32	419.83	1%
Prodhimi (ton)	991.2	865.82	1,048.88	1,010.48	2%
Rendimenti (t/ha)	2.4	2.7	2.4	2.4	0%
Pagesat direkte	19,977	16,957	29,343	29,423	47%
Njësi të subvencionuara	199.77	170	195.62	196.15	-2%
Nr. Përfituesve	61	67	72	67	10%
Sipërfaqja (ha) mesatare për fermer	6.80	4.75	6.03	6.27	-7.79%

Burimi: Raporti i Gjelbër 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Katalogu Ekonomik për Prodhime Bujqësore 2020

Mbështetja financiare për fermerët e këtij sektori ishte më e madhe në vitet 2018 dhe 2019, ku mbi 29.4 mijë euro u ndanë në vitin 2019 dhe 29.3 mijë euro në vitin 2018. Krahasuar me vitin 2017, pagesat për këto dy vite janë mbi 70 përqind më të larta ndërsa numri i përfituesve mbetet i njëjtë sikur në vitin 2017, kurse njësitë e subvencionuara janë rritur për 26 parcela.

3.6 Vreshta ekzistuese


Në Kosovë janë mesatarisht 3,200 hektarë tokë të mbjella me vreshta. Meqenëse synohet mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të mbjella aktuale si dhe shtimi i sipërfaqeve të reja, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në vitin 2013 zgjeroi programin e pagesave direkte edhe për fermerët e sektorit të vreshtarisë. Nga viti 2013 deri më 2019 janë shpërndarë rreth 15.5 milionë euro në formë të subvencioneve për fermerë/e.

Qëllimi i programit të pagesave direkte ndër vite për sektorin e vreshtarisë është rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore. Për të përfituar nga pagesat direkte, fermerëve që në pronësi të tyre kanë sipërfaqen e punueshme me vreshta u kërkohet të kenë të mbjella së paku 0.10 hektar me vreshta ku parcela e mbjellur e vreshtës duhet të jetë së paku 0.05 ha e pandarë. Ndërsa, fermerët qiramarrës kërkohet të paktën një vit të kenë paguar qiranë për së paku 0.10 ha (10 ari) parcelë të pandarë.²³

Në figurën 7 shohim se, përderisa, shuma e pagesave direkte pothuajse është trefishuar nga viti 2013 deri më 2019, sipërfaqja e mbjellur me vreshta ka mbetur relativisht e njëjtë me një rritje të lehtë prej 6.6%. Në të njëjtën kohë, prodhimi ka rënë për 30 përqind kryesisht për shkak të rënies së rendimentit të vreshtave nga viti 2013.

23 MBPZHR. Programi për pagesat direkte për vitin 2019. Burimi: <https://bit.ly/31mTtWf>

Figura 6. Sipërfaqja dhe pagesat direkte për vreshta ekzistuese gjatë viteve 2013-2019



Burimi: Raporti i Gjelbër 2014-2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Tabela 10. Indikatorët e performancës së pagesave direkte për vreshta ekzistuese për vitet 2013-2019

Vreshta	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2013
Sipërfaqja (ha) rrush tryeze	751	781	747	769	799	816	878	17%
Sipërfaqja (ha) rrush për verë	2,408	2,420	2,321	2,348	2,400	2,455	2,489	3%
Vreshta total	3,159	3,201	3,068	3,117	3,199	3,272	3,367	6.6%
Prodhi (ton)								
Rrush tryeze	7,137	4,869	6,996	6,866	3,187	4,998	4,546	-36%
Rrush për verë	20,473	15,101	18,426	16,800	12,177	22,324	14,772	-28%
Vreshta	27,610	19,970	25,422	23,666	15,364	27,322	19,318	-30%
Rendimenti (t/ha)								
Rrush tryeze	9.50	6.23	9.4	8.9	4	6.1	5.2	-45%
Rrush për verë	8.50	6.24	7.9	7.2	5.1	9.1	5.9	-31%
Vreshta	8.7	6.2	8.3	7.6	4.8	8.4	5.7	-34%
Pagesat direkte	1,124,516	2,290,783	2,046,167	2,117,978	2,266,235	2,580,250	2,988,810	166%
Njësi të subvencionuara ha	2,791	2,435	2,456	2,473	2,508	2,580	2,989	7%
Pagesa për ha	500/200	1000/300	1,00/300	1,000/400	1,000/500	1,000	1,000	
Nr. përfituesve	2,556	2,995	2,806	2,881	2,909	2,949	2,900	13%
Sipërfaqja (ha) mesatare për fermer	1.24	1.07	1.09	1.08	1.10	1.11	1.16	-6.45%

Burimi: Raporti i Gjelbër 2016- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Katalogu Ekonomik për Prodhime Bujqësore 2016 - 2020

Sipërfaqja e tokës së subvencionuar për fermer ka mbetur relativisht e njëjtë me një rënie të lehtë prej 5.6 përqind. Rënia e tokës së subvencionuar për fermer vështirëson rritjen e prodhimit në masë dhe përmirësimin e ekonomisë së shkallës.

Pagesat direkte në vreshta nuk duket të kenë arritur asnjë nga qëllimet e synuara përkundër rritjes së vazhdueshme të tyre. Nga 2012 deri më 2019 ka rënie të prodhimit dhe rendimentit, ndërsa në anën tjetër nuk duket të jetë përmirësuar struktura e fragmentuar e parcelave të mjellura me vreshta.

4. Subvencionet në blegtori dhe shpeztari

4.1 Lopë qumështore

Prodhimi i qumështit të lopës është sektori me potencialin më të lartë të blegtorisë në zëvendësimin e importit dhe në rritjen e eksportit. Qumështi, përveç konsumit të formës bazike, mund të përpunohet në një sërë produktesh të tjera si: djath, ajkë, jogurt, kos, jogurt i frutave e të tjera.

Problemet kryesore në prodhimtarinë e qumështit janë: fermat e vogla me pak krerë, prodhimi i qumështit nga fermerë për konsum vetanak, cilësia e qumështit dhe konkurrenca e lartë në treg nga produktet e importuara.

Në vitin 2019 në Kosovë ekzistojnë mbi 83 mijë ferma blegtorale, me rreth 257,733 krerë gjedhe ku prej të cilave 51% (131,939 krerë) janë lopë qumështore.²⁴ Numri mesatar i lopëve qumështore për familje është i ulët, me një deri në pesë krerë lopë. Pjesa më e madhe e prodhuesve të qumështit (94%) kanë deri në pesë lopë, ndërsa vetëm rreth 6% e fermerëve janë komerciale që kanë mbi pesë lopë.²⁵ Kjo strukturë e vogël e fermave vështirëson prodhimin në masë në mënyrë që prodhuesit vendor të jenë më konkurrent në treg.

Prodhimi vendor i qumështit në Kosovë është 321,189,946 litra, që do të thotë 1,245 litër qumësht për krerë. Një pjesë e madhe (12%) e qumështit përdoret për bagëti, konsum familjar ose ushqim për kafshë, pjesa tjetër shitet në tregjet e gjelbra ose përpunohet.²⁶ Niveli i cilësisë dhe higjienës së qumështit të grumbulluar në disa raste nuk është i kënaqshëm, pasi që standardet e Mjëljes së Mirë (GMH) nuk aplikohen tërësisht. Probleme të tjera ndërlidhen edhe me ndryshimin e prodhimtarisë së qumështit në ferma ku ka prodhimtari të ulët gjatë dimrit si pasojë e mungesës së ushqimit cilësor dhe prodhimtarisë së lartë gjatë verës.

Sa i përket subvencionimit të blegtorisë, lopët qumështore janë më të përkrahurat. Në vitin 2013, 53% e shumës totale të paguar ishin për lopë qumështore, 29% për dele dhe dhi, 12% për bletë dhe 6% për pula. Përkrahja e drejtpërdrejt e lopëve qumështore si pagesë për krerë është paraqitur në vitin 2010. Nga viti 2010 deri më 2019, janë realizuar mbi 30.8 milionë euro për fermer me qëllim që struktura e fermerëve të përmirësohet, prodhimi i qumështit të rritet dhe të orientohet nga konsumi vetanak në atë të tregut. Për këtë arsye, përfituesit e pagesave direkte duhet të kenë së paku 5 krerë lopë qumështore ose buallica qumështore të vaksionuara dhe të jenë në regjistrin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve. Më vonë, pagesat direkte për lopë qumështore u rritën nga 50 në 70 euro në mënyrë që të ofrohen stimuj shtesë në rritjen e kapacitetit prodhues.

Mirëpo, përkundër trefishimit të pagesave direkte ndër vite dhe rritjes së pagesave për krerë, numri i lopëve qumështore dhe prodhimi i qumështit është zvogëluar për rreth 30%. Gjatë viteve 2008-2009, numri i lopëve qumështore ishte rreth 60 mijë më i lartë se në vitet 2018-2019, ndërsa prodhimi i qumështit mbi 100 mijë ton.

Sa i përket strukturës së fermave, ka një rritje të lehtë të krerëve të subvencionuar për fermer. Në vitin 2010, për çdo përfitues u subvencionuan mesatarisht 8.6 krerë, kurse në vitin 2019 ky numër u rrit në 9.5 krerë. Ky është një ndryshim pozitiv, megjithatë jo i mjaftueshëm për të përmirësuar strukturën e fragmentuar të fermerëve që prodhojnë qumësht. Andaj, shpërndarja e pagesave direkte për nëntë vite nuk duket të ketë pasur ndikim në rritjen e prodhimtarisë së qumështit apo përmirësimit të strukturës së fermave.

²⁴ Anketa e ekonomive bujqësore 2019. Burimi: <https://bit.ly/3fcc3XF>

²⁵ Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Tregu i qumështit. Burimi: <https://bit.ly/33DS1zO>

²⁶ Anketa e ekonomive bujqësore 2019. Burimi: <https://bit.ly/3fcc3XF>


Tabela 11. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në prodhimin e qumështit 2008-2019

Ndryshimi
2019/2010

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	
Lopë qumështore	191,529	190,216	194,984	196,155	183,340	178,557	134,393	135,801	136,783	132,971	132,474	131,939	-32%
Prodhimi i qumështit (t)	381,238	379,576	390,065	393,389	368,605	369,702	278,933	282,534	285,261	277,976	277,599	277,138	-29%
Pagesat direkte			1,108,380	992,340	2,104,800	2,105,950	2,211,750	3,790,990	4,609,990	4,777,500	4,746,770	4,391,380	295%
Numri i krerëve të paguar			36,946	33,078	42,096	42,119	44,235	54,157	65,857	68,250	67,811	62,478	69%
Pagesa për krerë			30	30	50	50	50	70	70	70	70	70	133%
Nr. përfituesve			4,287	4,162	5,231	5,075	5,472	6,451	7,650	7,546	7,395	6,606	54%
Importet			71,252	75,960	72,371	66,582	67,863	67,491	69,284	68,007	70,596	76,139	7%

Burimi: Raporti i Gjelbër 2016- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 7. Prodhimi i qumështit, numri i krerëve dhe pagesat direkte gjatë viteve 2010-2019




Një tjetër linjë e përkrahjes së industrisë së qumështit është ajo e përmirësimit të cilësisë. Në vitin 2010, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural realizoi pagesa direkte apo subvencione sipas kategorisë së cilësisë së qumështit të prodhuar me qëllim që të ofrojnë stimuj për fermerë që të përmirësojnë cilësinë e prodhimit. Për klasën ekstra u ndanë 0.06 euro për litër qumësht, për klasën e parë 0.04 euro/litër dhe klasën e dytë 0.02 euro/litër. Cilësia kërkohet që të jetë e verifikuar nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) dhe të ofrohen dokumentet e tjera si dëshmi lidhur me kriteret subvencionuese sipas programit për sasinë e nevojshme për periudhën e caktuar.

Nga viti 2016 deri më 2019 janë shpenzuar mbi 6.5 milionë euro në pagesa direkte për prodhim të qumështit sipas cilësisë. Nga to, mbi 5.7 milionë euro janë shpenzuar për qumësht ekstra klasë, rreth 382 mijë për qumësht të klasit të dytë dhe 412.5 mijë euro për qumësht të klasit të parë. Sasia më e madhe e paguar i përket cilësisë më të lartë (klasa ekstra). Gjatë viteve vërehet një përmirësim i cilësisë, megjithatë, një numër i konsiderueshëm i qumështit të prodhuar vazhdon të mbetet në klasën e parë dhe të dytë.

Tabela 12. Pagesat direkte për cilësi të qumështit të prodhuar 2016-2019

Qumësht sipas cilësisë	Ekstra klasë	Klasa e parë	Klasa e dytë
Sasia e paguar 2019	30,393,357	2,901,695	5,575,577
Çmimi për cilësi (e/litr) 2019	0.06	0.04	0.02
Vlera e paguar 2019	1,823,601	116,068	111,512
Sasia e paguar 2018	24,489,274	3,533,833	6,650,620
Çmimi për cilësi 2018	0.06	0.04	0.02
Vlera e paguar 2018	1,469,356	141,353	133,012
Sasia e paguar 2017	24,925,179	1,977,264	5,245,751
Çmimi për cilësi 2017	1.56	1.04	0.52
Vlera e paguar 2017	1,495,511	79,091	104,915
Sasia e paguar 2016	16,119,175	1,128,905	3,152,656
Çmimi për cilësi 2016	1.56	1.04	0.52
Vlera e paguar 2016	967,150	45,156	63,053

Burimi: Agjenconi për Zhvillimin e Bujqësisë

Figura 8. Trendi i sasisë së qumështit në cilësi të ndryshme gjatë viteve 2010-2019

4.2 Pula vojse

Kultivimi i pulave vojse është një tjetër sektor me rëndësi të veçantë në Kosovë. Potenciali i tij qëndron tek baza e gjerë e konsumit të brendshëm të vezëve dhe mungesa e plotësimit të nevojave të brendshme nga prodhimi vendor. Ndër problemet kryesore të identifikuara të cilat pengojnë zhvillimin e sektorit të shpezëve janë madhësia e fermave, modernizimi teknologjik dhe ngritja e standardeve të sigurisë së ushqimit.²⁷

Për këtë qëllim, nga viti 2014 deri në vitin 2019 janë realizuar gjithsej rreth 2.5 milionë euro në pagesa direkte për përkrahjen e fermerëve në mënyrë që të intensifikojnë prodhimtarinë aktive. Madje, nga viti 2016, vlera e subvencionimit është rritur vazhdimisht duke u ndarë në dy kategori: subvencionimi për fermat që kanë 2 mijë deri në 10 mijë pula vojse me nga 0.50 € për krerë, fermat me mbi 10 mijë pula vojse përfitojnë 0.50 (për 10 mijë pula) dhe 0.40 € për krerë për pjesën tjetër.

²⁷ Ibid.


Deri në vitin 2019, numri i pulave në prodhimtarinë aktive vlerësohet të jetë rreth 1.9 milionë apo rreth 190 mijë më i lartë se në vitin 2018. Mirëpo, edhe në këtë sektor, përkundër përkrahjes së vazhdueshme të prodhimtarisë e cila nga viti 2013 deri në 2019 u rrit për 124%, numri i pulave shënoi rënie prej 8%. Përmirësim nuk duket të ketë pasur as madhësia e fermave, në vitin 2013 numri mesatar i krerëve të paguar për përfitues ishte 9,800 ndërsa në vitin 2019 ishte 1,441.

Tabela 13. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në industrinë e pulave vojse 2013-2019

Pula vojse	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2013
Numri i pulave	2,107,000	1,704,000	1,874,000	2,043,471	2,051,479	1,728,000	1,947,476	-8%
Pagesat direkte	240,305	231,648	210,868	346,259	435,035	484,343	537,497	124%
Numri i krerëve të paguar	567,996	526,966	466,064	783,531	960,955	1,023,671	1,181,829	108%
Pagesa për krerë	0.5/0.4/0.3	0.50/0.4	0.50/0.40	0.50/0.40	0.50/0.40	0.50/0.40	0.50/0.40	
Nr. përfituesve	58	59	57	78	80	81	82	41%

Burimi: Raporti i Gjelbër 2016- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 9. Trendi i numrit të pulave dhe pagesave direkte gjatë viteve 2013-2019



4.3 Koshere bletë

Zhvillimi (rritja dhe kultivimi) i bletëve është me rëndësi për prodhimtarinë bujqësore. Kërkesa për konsumin e mjaltit të bletëve në vendin tonë cilësohet e lartë. Në vitin 2019, prodhimtaria e mjaltit në Kosovë ishte rreth 2,198 ton duke plotësuar 91% të nevojave për konsum ndërsa pjesa tjetër e konsumit (229 ton) u plotësua me anë të importit. Kurse, në një masë tejet simbolik prej 75 kg u eksportua në Shqipëri.²⁸

Subvencionimi për bletari filloi në vitin 2012 ku deri më 2016 u ndanë 10 euro për shoqëri bletësh, ndërsa nga viti 2016 deri në vitin 2019, subvencionimi është rritur në 15 euro për koshere. Përfituesit pos tjerash kërkohet të mbarështojnë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere), ndërsa fermerët e certifikuar për prodhimtari organike të mjaltit subvencionohen në vlerë prej 20 euro për koshere.²⁹

²⁸ Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë. Raporti i Gjelbër 2020. Burimi: <https://bit.ly/3vORXKy>

²⁹ MBPZHR, Programi për pagesa direkte për vitin 2019. Burimi: <https://bit.ly/3vWOYz4>

Nga viti 2012 deri në vitin 2019, shuma e pagesave direkte që janë shpërndarë për përkrahjen e prodhimit të bletarisë është mbi 12.7 milionë euro. Këto pagesa shënuan ngritje nga viti në vit. Mirëpo, për dallim nga kulturat bujqësore të tjera, me rritjen e pagesave direkte u rrit edhe numri i koshereve të bleteve. Ndonëse përqindja e rritjes së pagesave direkte ishte më e lartë se e përqindjes së rritjes së numrit të koshereve të bleteve.


Tabela 14. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në industrinë e bletëve 2012-2019

Ndryshimi
2019/2012

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	
Koshere të bletëve	46,483	93,533	116,172	157,005	162,355	163,717	182,476	219,831	373%
Pagesat direkte	358,610	500,660	777,610	1,129,580	2,158,770	2,295,555	2,471,085	3,070,950	756%
Numri i koshereve të paguara	35,861	50,066	77,761	112,958	143,918	153,037	164,739	204,730	471%
Pagesa për koshere	10	10	10	10	15	15	15	15	50%
Nr. Përfituesve	779	985	1394	1,918	2,353	2,467	2,764	3,238	316%

Burimi: Raporti i Gjellbër 2016- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 10. Trendi i numrit të koshereve të bletëve dhe pagesave direkte gjatë viteve 2012-2019



4.4 Dele dhe dhi

Delet edhe dhitë janë kafshë blegtorale me rëndësi shumë të madhe në prodhimtarinë ushqyese. Qumështi i deleve dhe dhive përdoret për konsum nga njerëzit dhe cilësohet me vlera të larta ushqyese. Krahas peshës së saj, dhia jep më shumë qumësht nga çdo kafshë tjetër. Sasia e qumështit të dhisë sillet nga 1.8 deri në 2.7 litra qumësht në ditë. Përveç prodhimtarisë ushqyese, delet dhe dhitë kanë poashtu rëndësi të madhe ekonomike. Materiet ushqyese të marra i shndërrojnë në prodhime të tjera të çmueshme, si mish, lesh, lëkurë, gëzof, pleh e të tjerë.

Numri i deleve dhe dhive në Kosovë është rreth 216,299 krerë. Subvencionimi i tyre filloi në vitin 2010, ku deri në vitin 2014 u ndanë 10 euro për krerë ndërsa nga viti 2015 deri në vitin 2019 subvencionimi u rrit në 15 euro për krerë. Kjo masë kishte për qëllim shtimin e krerëve e rrjedhimisht rritjen e prodhimit. Fermerëve aplikues ju kërkohet të mbarështojnë së paku 30 krerë dele dhe së paku 20 krerë

dhi qumështore në prodhimtarinë aktive të qumështit ndërsa kafshët e tyre duhet të jenë të matrikulluar (kafshë riprodhuese).


Deri në vitin 2019, për fermerët e këtij sektori janë ndarë gjithsej 16.89 milionë euro. Subvencionet për këtë kategori shënuan rritje të vazhdueshme. Nga viti 2010 deri në 2019, pagesat direkte u rritën për afër 89%. Në anën tjetër, numri i deleve dhe dhive ishte 216,299 apo rreth 13 mijë më pak se në vitin 2010.

Tabela 15. Indikatorët e performancës së pagesave direkte në kategorinë e deleve dhe dhive 2010-2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Ndryshimi 2019/2012
Fondi i deleve dhe dhive	229,157	231,209	247,901	216,577	212,014	224,096	212,040	210,688	209,808	216,299	-6%
Numri i përfituesve	1,559	1,343	1,449	1,252	1,295	1,287	1,273	1,334	1,378	1,355	-13%
Numri i krerëve të paguar	127,634	123,807	132,745	115,972	121,012	128,091	128,883	140,854	153,241	160,768	26%
Pagesa për krerë	10	10	10	10	10	15	15	15	15	15	50%
Pagesat direkte	1,276,340	1,238,070	1,327,450	1,159,720	1,210,120	1,921,365	1,933,245	2,112,810	2,298,615	2,411,520	89%

Burimi: Raporti i v 2016- 2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Figura 11. Trendi i numrit të deleve dhe dhive dhe pagesave direkte gjatë viteve 2010-2019



5. Përfundimi

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e bilancit tregtar dhe në rritjen e punësimit. Megjithatë, në Kosovë ky sektor ende nuk ka arritur zhvillimin e mjaftueshëm për të qenë konkurrent me produktet e importuara, veçanërisht në ato ushqimore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vlerësuar së ndër mangësitë kryesore të cilat vështirësojnë zhvillimin e bujqësisë janë: struktura e vogël e fermave, niveli i lartë i fragmentimit të tokave dhe mungesa e investimeve në asete fizike të fermave apo kapaciteteve prodhuese. Si rrjedhojë, ky institucion ka hartuar politika mbështetëse të cilat synojnë përmirësimin e këtyre problemeve.

Një ndër programet kryesore mbështetëse që synon të adresojë problemin strukturor të fermave janë pagesat direkte (subvencionet).

Nga viti 2015 deri më 2019 janë shpërndarë rreth 134.7 milionë euro në pagesa direkte nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në drithëra, vreshta, blegtori dhe shpeztari.³⁰ Mirëpo bazuar në të dhënat e prezentuara më lartë, pothuajse në shumicën e kulturave bujqësore, prodhimi, sipërfaqja e mbjellur dhe rendimenti në vitin 2019 nuk duket të kenë ndryshuar shumë krahasuar me periudhën para fillimit të politikave mbështetëse. Në raste ku ka rritje të prodhimit apo të rendimentit, kjo rritje është më e vogël se shuma e pagesave të dedikuara për atë sektor. Shpërndarja e pagesave direkte ka vazhduar e në disa raste është rritur përkundër mungesës së rezultateve të pritura. Kjo vazhdimësi mund të ketë ndodhur edhe nga fakti se MBPZHR nuk ka bërë ndonjë vlerësim sistematik të ndikimit të politikave mbështetëse nga hartimi i tyre.

Mungesa e zhvillimit të bujqësisë përkundër mbështetjes së lartë financiare vë në pikëpyetje efektshmërinë e politikave bujqësore të hartuara mbi dhjetë vite më parë apo mënyrën e shpërndarjes së tyre. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, menaxhimi i sektorit të bujqësisë ka mangësi të mëdha. Përkundër programeve dhe shumave që ndahen me rreth 48 milionë euro çdo vit, nuk janë arritur rezultatet e duhura. Përveç kësaj, në shkurt të vitit 2021 u hap një proces gjyqësor ndaj disa zyrtarëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë nën dyshimin e keqpërdorimit të shpërndarjes së pagesave direkte.³¹ Të gjitha këto zhvillime kërkojnë rishikim të menjëhershëm të programeve bujqësore dhe zbatimit të tyre.

Marrë parasysh potencialin e sektorit të bujqësisë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe mungesës së rezultateve dhjetë vjet pas fillimit të mbështetjes së këtij sektori, Instituti GAP rekomandon:

- Të bëhet një vlerësim i detajuar nëse mungesa e rezultateve të pritshme është si pasojë e politikave bujqësore joadekuata apo nga menaxhimi jo i duhur i fondeve.
- Të rishikohet mundësia e avancimit të programeve ekzistuese të politikave mbështetëse aty ku nuk kanë dhënë rezultate të pritura.
- Secila masë të ketë tregues të qartë të matjes së suksesit të saj.
- Të funksionalizohet Departamenti i monitorimit dhe vlerësimit të efektshmërisë së masave bazuar në indikatorët e vendosur.
- Të bëhet rishikim dhe vlerësim i rregullt i politikave bujqësore.

³⁰ MBPZHR, Bujqësia e Kosovës në numra 2020. Burimi: <https://bit.ly/33xwLfb>

³¹ Gazeta "Koha Ditore". Burimi: <https://bit.ly/2PKQowv>


Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org



Instituti GAP përkrahët nga:

